



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Raporti përfundimtar

Auditimi i raporteve vjetore financiare të subjekteve politike
Pasqyrat financiare të vitit 2023

Dokumenti “Raporti vjetor i auditimit për vitin 2023” u hartua nga Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Sipas paragrafit 18 të nenit 19 të Ligjit Nr. 08/L-122 për Financimin e Subjekteve Politike, Zyra përgatit raportin vjetor për KQZ dhe i njëjti i pa ndryshuar si aneks i raportit nga KQZ, i përcillet Kuvendit të Republikës së Kosovës, që përmban informatat për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, duke përfshirë të gjeturat e dala nga procesi i auditimit të vitit 2023 dhe rekomandimet me qëllim të avancimit të mëtejshëm të mekanizmave për financimin e subjekteve politike sidomos në aspekt të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Raporti përmban të dhënat e përgjithshme të auditimit të raporteve vjetore financiare të vitit 2023, duke përfshirë të dhënat për shqiptimin e gjobave.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

www.kqz-ks.org

Rruga Migjeni, Nr. 21

10 000, Prishtinë

Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

1.	Të dhënat e përgjithshme rreth auditimit.....	3
2.	Shpërndarja dhe shpenzimet e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.....	4
2.1.	Shpërndarja e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2023.....	4
2.2.	Shpenzimi i mjeteve të fondit për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2023.....	5
2.2.1.	Shpenzimi i mjeteve sipas linjave apo kategorive të shpenzimeve për vitin 2023.....	6
2.2.2.	Donacionet dhe kontributet në vitin 2023.....	10
3.	Auditimi i raporteve vjetore financiare të vitit 2023.....	11
3.1.	Opinionit i auditorëve për gjetjet e vitit 2023.....	12
4.	Shqiptimi i gjobave për subjektet politike.....	12
5.	Shqiptimi i gjobave për personat e autorizuar të subjekteve politike.....	14
6.	Shqiptimi i vërejtjeve për subjektet politike.....	15
7.	Adresimi i të gjeturave nga auditimi për vitin 2023.....	15
7.1.	Administrata Tatimore e Kosovës.....	16
7.2.	Zyra e Prokurorit të Shtetit.....	17
8.	Aktivitetet e Zyrës në mbikëqyrjen financiare përgjatë vitit 2024.....	18
9.	Rekomandimet.....	20

1. Të dhënat e përgjithshme rreth auditimit

Sipas Ligjit Nr. 08/L-122 për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP)¹, Raportet Vjetore Financiare si dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në Zyrën për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) auditohen në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë.

Zyra, ka përzgjedhur auditorët e licencuar, të cilët kanë audituar raportet financiare vjetore për vitin 2023 dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut dhe Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet Komunale në komunat Zveçan dhe Leposaviq, të mbajtura me datën 23.04.2023 (tutje referuar Zgjedhjet e vitit 2023).

Procesi i përzgjedhjes së auditorëve, iu është nënshtruar kërkesave ligjore të LFSP, si në vijim:

- të jenë auditor të licencuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
- të kenë përvojë pune së paku tre (3) vjeçare në fushën e auditimit;
- personat fizik ose juridik të përzgjedhur të mos kenë pasur raporte kontraktuale me ndonjërin nga subjektet politike gjatë tre (3) viteve e fundit;
- të mos kenë qenë donatorë të ndonjërit nga subjektet politike apo të kenë përfituar në ndonjë mënyrë nga subjektet politike gjatë pesë (5) viteve të fundit;
- të mos ketë të ngritur aktakuzë apo i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale;
- të paraqes një listë me të gjitha auditimet që ka kryer gjatë tre (3) viteve të fundit.

Procesi i prokurimit të shërbimit të auditimit ka qenë i ndarë në dy (2) lote, si në vijim:

- LOT 1: Raportet vjetore financiar të partive politike për vitin 2023;
- LOT 2: Raportet vjetore financiare të partive politike për vitin 2024.

Për lotet e mësipërme, kanë dorëzuar dokumentet e aplikimit, vetëm dy (2) operator ekonomik, ndërsa operatori ekonomik Audit&Conto, është përzgjedhur si operator fitues, për auditimin e raporteve vjetore financiar për vitet 2023 dhe 2024.

Operatori ekonomik, Audit&Conto, për periudhën 2023, ka audituar pesëdhjetë e katër (54) raporte vjetore financiare.

¹ Ligji Nr. 08/L-122 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjit Nr. 04/L-122.

2. Shpërndarja dhe shpenzimet e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politik për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

2.1. Shpërndarja e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e partive politike për vitin 2023

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) sipas vendimit nr. 03-52-2023, datë 19.01.2023, kishte caktuar lartësinë e mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Partive Politike, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, në vlerën totale: 4, 200.000 euro.

Nga 4,200.000 euro:

- a) 3,780.000 euro ishin ndarë si shumë për subjektet politike;
- b) 420.000 euro, ishin ndarë si shumë për shpenzimet e deputetëve.

Tabela 1: Shpërndarja e mjeteve financiare sipas kategorizimit për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Nr. rendor	Emri i subjektit politik	Nr. i ulëseve	Shuma për subjektet politike	Shuma për shpenzime të deputetëve	Shuma totale
1	Lëvizja VETËVENDOSJE!	58	1,827,000	203,000	2,030,000.00
2	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	19	598,500	66,500	665,000
3	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	15	472,500	52,500	525,000
4	SRPSKA LISTA	9	283,500	31,500	315,000
5	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	8	252,000	28,000	280,000
6	KOSOVA DEMOKRATÏK TÛRK PARTÏSÏ	2	63,000	7,000	70,000
7	KOALICIJA VAKAT	1	31,500	3,500	35,000
8	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	1	31,500	3,500	35,000
9	ROMANI INICYATIVA	1	31,500	3,500	35,000
10	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	1	31,500	3,500	35,000
11	SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA	1	31,500	3,500	35,000
12	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	1	31,500	3,500	35,000
13	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	1	31,500	3,500	35,000
14	GRAĐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSATANK	1	31,500	3,500	35,000
15	LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS	1	31,500	3,500	35,000
TOTALI	15 SUBJEKTE POLITIKE	120	3,780,000 euro	420,000 euro	4,200,000 euro

2.2. Shpenzimi i mjeteve nga Fondi për mbështetjen e partive politike për vitin 2023

Në vijim, Zyra paraqet të dhënat për shpenzimet (SH. Sh1 deri Sh 7) e subjekteve politike që janë përfituese të mjeteve të fondit për mbështetjen e subjekteve politike, në raport me shumën që u janë ndarë këtyre subjekteve në vitin 2023.

Pesëmbëdhjetë (15) subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kishin shpenzuar në total: 3,460,379.08€ nga 4,653,964.50€ euro të ndara nga fondi dhe kontributet në të holla.

Subjektet politike i kishin shfrytëzuar mjetet financiare të ndara nga fondi, në masën 74.35%.

Tabela 2: Shfrytëzimi i mjeteve financiare të Fondit për Mbështetjen e Partive Politike.

Nr. rendor	Emri i subjektit politik	Të hyrat për vitin 2023	Shpenzimet në vitin 2023	Përqindja e shfrytëzimit
1	Lëvizja VETËVENDOSJE!	2,000,750.24€	1,384,154.49€	69.18%
2	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	951,483.00€	717,543.90€	75.41%
3	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	723,169.92€	431.824.38€	59.71%
4	SRPSKA LISTA	314,348.56€	295,917.94€	82.68%
5	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	280,000€	268,016.28€	95.72%
6	KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	73,143.66€	71,711.61€	98%
7	KOALICIJA VAKAT	35,367.90€	35,314.98€	99.85%
8	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	35,000€	32,798.07€	93.70%
9	ROMANI INICYATIVA	32,367.78€	58,238.59€	25,870.81€ të shfrytëzuara më shumë
10	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	35,000€	33,561.42€	95.88%
11	SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA	35,000€	31,604.43€	90.29%
12	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	35,000€	22,550.49€	64.42%
13	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	35,000€	35,000€	100%
14	GRAÐANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSATANK	33,829.44€	8,351.69€	24.68%
15	LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS	34,504€	33,790.81€	97.93%
TOTALI	15 SUBJEKTE POLITIKE	4,653,964.50€	3,460,379.08€	74.35%

2.2.1. Shpenzimi i mjeteve, sipas linjave apo kategorive të shpenzimeve për vitin 2023

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
Lëvizja VETËVENDOSJE!	1,384,154.49€	Pagat dhe kompensimet	764,908.32€	55.26%
		Shpenzimet e transportit	82,811.37€	5.98%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	149,838.51€	10.82%
		Shpenzimet e fushatës	5,967.81€	0.43%
		Blerja e mallrave	47,203.46€	3.41%
		Shpenzimet e përgjithshme	307,949.55€	22.24%
		Shpenzimet e ndryshme	25,475.47€	1.84%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	717,543.90€	Pagat dhe kompensimet	561,711.49€	78.28%
		Shpenzimet e transportit	21,222.55€	2.95%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	46,494.24€	6.47%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	3,872.09€	0.53%
		Shpenzimet e përgjithshme	57,381.48€	8%
Shpenzimet e ndryshme	26,861.95€	3.74%		

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	431,824.38€	Pagat dhe kompensimet	276,504.88€	64%
		Shpenzimet e transportit	22,704.41€	5.25%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	64,856.72€	15%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	3,935.20€	0.91%
		Shpenzimet e përgjithshme	62,097.48€	14.38%
		Shpenzimet e ndryshme	1,725.69€	0.4%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
SRPSKA LISTA	295,917.94€	Pagat dhe kompensimet	130,349.21€	44%
		Shpenzimet e transportit	6,143.61€	2%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	101,196.65€	34%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	00	/
		Shpenzimet e përgjithshme	43,394.87€	14.66%
		Shpenzimet e ndryshme	14,833.90€	5%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	268,016.28€	Pagat dhe kompensimet	185,831.88€	69.33%
		Shpenzimet e transportit	1,467.90€	0.54%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	17,508.79€	6.53%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	8,359.80€	3.11%
		Shpenzimet e përgjithshme	42,922.91€	16%
		Shpenzimet e ndryshme	11,925.00€	4.44%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	71,711.61€	Pagat dhe kompensimet	30,554.88€	42.6%
		Shpenzimet e transportit	3,591.43€	5%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	2,210€	3%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	00	/
		Shpenzimet e përgjithshme	31,165.76€	43.45%
		Shpenzimet e ndryshme	4,189.54€	5.84%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
KOALICIJA VAKAT	35,314.98€	Pagat dhe kompensimet	14,687.07€	41.58%
		Shpenzimet e transportit	730€	2%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	3,517.30€	10%
		Shpenzimet e fushatës	10,445€	29.57%
		Blerja e mallrave	1,415€	4%
		Shpenzimet e përgjithshme	4,038.16€	11.43%
		Shpenzimet e ndryshme	428.45€	1.21%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	32,798.07€	Pagat dhe kompensimet	13,496.23€	41.14%
		Shpenzimet e transportit	3,675.36€	11.20%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	11,195.11€	34.13%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	00	/
		Shpenzimet e përgjithshme	3,070€	9.36%
		Shpenzimet e ndryshme	1,361.37€	4.15%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
ROMANI INICYATIVA	58,238.59€	Pagat dhe kompensimet	26,508.03€	45.51%
		Shpenzimet e transportit	8,438.82€	14.49%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	5,768.80€	9.9%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	1,057€	1.81%
		Shpenzimet e përgjithshme	706.85€	1.21%
		Shpenzimet e ndryshme	15,759.09€	27%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	33,561.42€	Pagat dhe kompensimet	11,021.72€	32.84%
		Shpenzimet e transportit	1,722.20€	5.13%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	16,468.90€	49%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	72.70€	0.21%
		Shpenzimet e përgjithshme	3,948.90€	11.76%
		Shpenzimet e ndryshme	327€	0.97%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA	31,604.43€	Pagat dhe kompensimet	18,248.94€	57.74%
		Shpenzimet e transportit	1,160.71€	3.32%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	4,076.41€	12.89%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	2,690.03€	8.51%
		Shpenzimet e përgjithshme	2,091.28€	6.61%
		Shpenzimet e ndryshme	3,337.06€	10.55%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	22,550.49€	Pagat dhe kompensimet	5,102.88€	22.62%
		Shpenzimet e transportit	5,082€	22.53%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	4,317.01€	19.14%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	133.15€	0.59%
		Shpenzimet e përgjithshme	6,830.05€	30.28%
		Shpenzimet e ndryshme	1,685.40€	7.47%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	35,000€	Pagat dhe kompensimet	19,279.10€	55%
		Shpenzimet e transportit	2,070€	5.9%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	450€	1.28%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	3,708€	10.59%
		Shpenzimet e përgjithshme	7,350€	21%
		Shpenzimet e ndryshme	2,142.25€	6.12%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
GRADANSKA INICIJATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSATANK	8,351.69€	Pagat dhe kompensimet	00	/
		Shpenzimet e transportit	1,504.86€	18%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	940€	11.25%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	00	/
		Shpenzimet e përgjithshme	603.30€	7.22%
		Shpenzimet e ndryshme	5,303.53€	63.5%

Emri i subjektit politik	Mjetet e shfrytëzuara për vitin 2023	Qëllimi	Shfrytëzimi i mjeteve	Përqindja %
LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS	33,790.81€	Pagat dhe kompensimet	15,933.25€	47.15%
		Shpenzimet e transportit	3,319.50€	9.82%
		Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	7,735.66€	22.89%
		Shpenzimet e fushatës	00	/
		Blerja e mallrave	1,021.31€	3%
		Shpenzimet e përgjithshme	2,239.89€	6.62%
		Shpenzimet e ndryshme	3,541.20€	10.48%

2.2.2. Donacionet dhe kontributet në vitin 2023

Në periudhën raportuese që fillon me datën 01.01.2023 dhe përfundon me datën 31.12.2023:

- a) Nga pesëdhjetë e katër (54) subjekte politike gjithsejtë, njëmbëdhjetë (11) subjekte politike, kanë pranuar donacione/ kontribute në të holla.

Tabela 3: Subjektet politike që kanë pranuar donacione në të holla në vitin 2023

Nr. rendor	Emri i partisë politike	NË TË HOLLA
1	LËVIZJA PËR BASHKIM	10,540€
2	ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT	500€
3	ALEANCA KOSOVA E RE	49,640€
4	ALTERNATIVA	940€
5	KOSOVA DEMOKRATËK TÛRK PARTËSË	2,000€
6	Lëvizja VETËVENDOSJE!	22,366€
7	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	39,483€
8	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	400€
9	PARTIA SHQIPTARE DEMOKRATISIANE E KOSOVËS	3,250€
10	PARTIA SOCIALDEMOKRATE	23,306.25€
11	YENËLIKÇI TÛRK HAREKET PARTËSË	1,680€

Vlera total e donacioneve në të holla, është: 154,105.25€;

Ndërsa, vetëm gjashtë (6) subjekte politike, në periudhën raportuese 2023, kanë pranuar donacione apo kontribute në natyrë, në vlerën totale: 5,720€.

- PARTIA REPUBLIKANE PËR NDRYSHIME, në vlerën 1,200€;
- INICIATIVA BALLI, në vlerën 480€;
- SHPRESA DEMOKRATE, në vlerën 640€;
- POKRET ZA GORA, në vlerën 360€;
- PARTIA SOCIALDEMOKRATE, në vlerën 40€;
- ALEANCA KOSOVA E RE, në vlerën 3,000€.

3. Auditimi i raporteve vjetore financiare të vitit 2023

Pas përzgjedhjes së operatorit ekonomik “Audit&Conto, me datën 15.04.2024, është organizuar tërheqja e shortit në tri (3) vazo. Në vazon e parë, janë përfshirë emrat e auditorëve të licencuar, në vazon e dytë (2) janë përfshirë emrat e partive politike të regjistruara dhe në vazon e tretë (3) janë përfshirë emrat e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Sipas shortit, dhjetë (10) auditorët janë caktuar sipas shortit, që t'i auditojnë gjithsejtë pesëdhjetë e katër (54) subjekte politike. Pas tërheqjes së shortit, auditimi i subjekteve politike për pasqyra vjetore financiare 2023, ka fillur me datën 18.04.2024.

Operatori ekonomik “Audit&Conto” ka audituar gjithsejtë pesëdhjetë e katër (54) subjekte politike, për periudhën raportuese 01.01.2023 – 31.12.2023. Nga 54 subjekte politike gjithsejtë, 15 subjekte politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përfitojnë mjete financiare nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike.

Zyra, me datën 25.06.2024, nga operatori ekonomik, ka pranuar raportet përfundimtare të auditimit. Me datën 28.06.2024, Zyra, përmes e-mailit, i kishte dërguar të gjitha raportet përfundimtare të auditimit, në adresat elektronike të kryetarëve të subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre financiar. Raportet përfundimtare të auditimit janë publikuar në ueb faqen e KQZ, në linkun (gjuhë shqipe) <https://kqz-ks.org/sherbime-per-subjektet-politike/raportet-vjetore-financiare-te-audituar/> (gjuhën serbe) <https://kqz-ks.org/sr/usluge-za-politicke-subjekte/revidirani-godisnji-finansijski-izvestaji/>

Lista e subjekteve politike të audituara për vitin 2023.

LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	FJALA
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT
PARTIA E DREJTËSISË	NISMA SOCIALDEMOKRATE
KOSOVA DEMOKRATÏK TÛRK PARTÏSÏ	SRPSKA LISTA
PARTIA SOCIALDEMOKRATE	LËVIZJA VETËVENDOSJE!
PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVË	PARTIJA KOSOVSKIH SRBA
STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE	ALTERNATIVA
BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS	PARTIA URA
DEMOKRATSKA STRANKA BOŠNJAKA	LËVIZJA PËR BASHKËVEPRIM
INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	PARTIA BALLIST
PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA
ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	YENÏLIKÇÏ TÛRK HAREKET PARTÏSÏ
GRADANSKA INICIJATIVA GORE	NAŠA INICIJATIVA
PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	PARTIA REPUBLIKANE PËR NDRYSHIME
DEMOKRATSKA STRANKA VATAN	INICIATIVA BALLI
ALEANCA KOSOVA E RE	BOŠNJAÇKA STRANKA KOSOVA
LËVIZJA PËR BASHKIM	KOSOVA ADALET TÛRK PARTÏSÏ
EKO LËVIZJA E GJELBËR	PARTIA DEMOKRATIKE E DIASPORËS
NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	LËVIZJA FORCA E DIASPORËS
PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	GUXO
KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA	BASHKIMI PËR NDRYSHIM ANAMORAVA
PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	SHPRESA DEMOKRATE
REPUBLIKANËT E KOSOVËS	SRPSKA DEMOKRATIJA
JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS
LËVIZJA QYTETARE VATRA	ROMANI INICIYATIVA
POKRET ZA GORA	GI ZA SLOBODU PRAVDU I OPSATANK
PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETTT	KOALICIJA VAKAT

3.1. Opinioni i auditorëve për gjetjet e vitit 2023

Nga të gjeturat e auditorit, raportet përfundimtare të auditimit, grupohen në tri (3) kategori opinionesh:

- a) Opinion i pa kualifikuar: pesë (5) subjekte politike;
- b) Opinion i kualifikuar: katërbëdhjetë (14) subjekte politike;
- c) Mohim opinionit: tridhjetë e pesë (35) subjekte politike.

Gjatë auditimit, auditorët ligjor kanë konstatuar se, për pesë (5) subjekte politike përgjatë periudhës raportuese 01.01.2023 – 31.12.2023, nuk janë evidentuar shkelje të dispozitave të Ligjit për Financimin e subjekteve politike, për të cilat shqiptohen gjoba në përputhje me nenin 21, për subjektet politike si në vijim:

- ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS;
- PARTIA SOCIALDEMOKRATE;
- ALEANCA KOSOVA E RE;
- Lëvizja VETËVENDOSJE!
- PARTIA LIBREALE EGJIPTIANE.

4. Shqiptimi i gjobave për subjektet politike

Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave për të gjeturat e periudhës raportuese 2023, janë publikuar në ueb faqen e KQZ.

- Në gjuhën shqipe: <https://kqz-ks.org/vendimet-e-zrckfsp/>
- Në gjuhën serbe: <https://kqz-ks.org/sr/odluke-rpfkps/>

Për të gjeturat nga raportet përfundimtare të auditimit për pasqyrat vjetore financiare 2023, Zyra ka shqiptuar gjithsejtë: njëzet (20) gjoba, që përfshijnë gjithsejtë: katërbëdhjetë (14) subjekte politike.

Nga katërbëdhjetë (14) subjekte politike:

- Shtatë (7) subjekte politike, përfaqësohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Shtatë (7) subjekte politike, nuk përfaqësohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Gjobat e shqiptuara: 4 mars 2024		Shkelja	Vlera e gjobës
1	PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS	Raporti vjetor financiar, i dorëzuar pas 1 marsit 2024.	4,000 euro.
2	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	Raporti vjetor financiar, i dorëzuar pas 1 marsit 2024.	4,000 euro.
3	EKO LËVIZJA E GJELBËR	Raporti vjetor financiar, i dorëzuar pas 1 marsit 2024.	4,000 euro.

Gjobat e shqiptuara: 10 korrik 2024		Shkelja	Vlera e gjobës
1	PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS	Pranim i donacioneve në para të gatshme.	4,000 euro.
2	PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS	Nuk ka bashkëpunuar me auditorin.	4,000 euro.
3	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	Pranim i donacioneve në para të gatshme.	4,000 euro.
4	LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS	Shfrytëzimi i mjeteve në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.	4,000 euro.
5	GRAÐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK	Nuk ka publikuar raportin vjetor financiar në ueb faqen zyrtare funksionale të subjektit politik	4,000 euro.
6	GRAÐANSKA INICIATIVA ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK	Shfrytëzimi i mjeteve në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.	4,000 euro.
7	SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA	Shfrytëzimi i mjeteve në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të mjeteve financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.	4,000 euro.
8	SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA	Nuk dëshmohet me asnjë dokument mbështetës, shpenzimi i realizuar.	4,000 euro.

Gjobat e shqiptuara: 11 korrik 2024		Shkelja	Vlera e gjobës
1	YENILIKÇI TÜRK HAREKET PARTISI	Nuk dëshmohet me asnjë dokument mbështetës, shpenzimi i realizuar.	4,000 euro.
2	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	Ka shfrytëzuar lokalin për zyrë, të cilin nuk e ka paraqitur si shpenzim për qira apo si kontribut në natyrë.	4,000 euro.
3	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	Nuk ka ofruar dokumentet mbështetëse për auditorin, dhe nuk ka bashkëpunuar.	4,000 euro.
4	ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT	Pranim i donacioneve në para të gatshme.	4,000 euro.
5	LËVIZJA PËR BASHKIM	Ka shfrytëzuar lokalin për zyrë, të cilin nuk e ka paraqitur si shpenzim për qira apo si kontribut në natyrë.	4,000 euro.

Gjobat e shqiptuara: 12 korrik 2024		Shkelja	Vlera e gjobës
1	INICIATIVIA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	Nuk dëshmohet me asnjë dokument mbështetës, shpenzimi i realizuar.	4,000 euro.
2	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	Nuk ka paraqitur dëshmitë për shfrytëzimin e selisë qendrore në Prishtinë.	5,000 euro.
3	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	Nuk ka paraqitur dëshmitë për shfrytëzimin e zyrave nëpër komunat e Republikës së Kosovës.	5,000 euro.
4	GUXO	Ka shfrytëzuar lokalën për zyrë, të cilin nuk e ka paraqitur si shpenzim për qira apo si kontribut në natyrë.	4,000 euro.

5. Shqiptimi i gjobave për personat e autorizuar të subjekteve politike

Për personat e autorizuar të subjekteve politike, Zyra me datën 19.07.2024, ka shqiptuar gjobat si në vijim:

- a) Për kryetarin e subjektit politik PARTIA E ASHLALINJËVE TË KOSOVËS, ka shqiptuar gjobën në vlerën një mijë (1,000) euro, sipas paragrafit 8 të nenit 21 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, për shkak se është vërtetuar mos bashkëpunimi i subjektit politik me auditorin, ku kryetari ka qenë i njoftuar në të gjithë komunikimin e auditorit ligjorë që ka realizuar me subjektin politik.
- b) Për kryetarin e subjektit politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, ka shqiptuar gjobën në vlerën një mijë (1,000) euro, sipas paragrafit 8 të nenit 21 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, për shkak se është vërtetuar se pagesat e realizuara janë në kundërshtim me qëllimin e përdorimit të fondit, siç përcaktohet me nenin 8 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

6. Shqiptimi i vërejtjeve për subjektet politike

Për njëzet (20) subjekte politike të regjistruar, të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, auditorët kanë dhënë opinionin “Mohim Opinioni” me arsyetimin se, pasqyrat financiar nuk paraqesin asnjë aktivitet financiar për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.

Duke qenë se këto subjekte politike, në statutet e tyre dhe sipas regjistrimit të partive politike, kanë të deklaruar selitë, të cilat nuk i kanë deklaruar si të hyrë nga kontributi në natyrë, në mallra dhe shërbime ose si të hyra nga qiratë, Zyra përmes vendimeve iu ka shqiptuar vërejtje, përmes të cilave, i ka obliguar që në raportet vjetore financiar për vitin raportues 2024, që dorëzohen më së voni me datën 1 mars 2025, t'i paraqesin selitë, ose si kontribute në natyrë, në mallra dhe shërbime, ose si të hyra nga qiratë.

Shqiptimi i vërejtjeve përmes vendimeve, përfshijnë këto subjekte politike: LËVIZJA PËR BASHKËVEPRIM, KOSOVA ADALET TÛRK PARTISI, STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE, BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS, GRADANSKA INICIJATIVA GORE, EKO LËVIZJA E GJELBËR, KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA, REPUBLIKANËT E KOSOVËS, LËVIZJA QYTETARE VATRA, POKRET ZA GORA, PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT, PARTIJA KOSOVSKIH SRBA, PARTIA BALLISTE, PARTIA REPUBLIKANE PËR NDRYSHIME, BOŠNJAČKA STRANKA KOSOVA, PARTIA DEMOKRATIKE E DIASPORËS, FJALA, Bashkimi për Ndryshim ANAMORAVA, PARTIA E DREJTËSISË dhe INICIJATIVA BALLI.

7. Adresimi i të gjeturave nga auditimi për vitin 2023

Sipas paragrafit 17, të nenit 19, të Ligji Nr. 08/L-122 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjit Nr. 04/L-122, Zyra i dorëzon Raportet Përfundimtare kur dyshimi për parregullsi bie nën kompetencën e njërës nga institucionet më poshtë:

- a) në Zyrën e Prokurorit të Shtetit;
- b) në Agjencinë Kundër Korrupsionit,
- c) në Njësinë e Inteligjencës Financiare;
- d) në Administratën Tatimore të Kosovës.

7.1. Administrata Tatimore e Kosovës

Raportet përfundimtare të auditimit për pesë (5) subjekte politike, i janë dorëzuar Administratës Tatimore të Kosovës, përmes shkresës përcjellëse, që përmban numrin e protokollit të Zyrës, Nr. 380/ 16.07.2024, siç përcaktohet sipas paragrafit 17 të nenit 19 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

Tabela 4: Raportet përfundimtare të auditimit që përmbajnë parregullsi, të dërguara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Nr.	Subjekti politik	Gjetja
1	KOSOVA DEMOKRATÏK TÛRK PARTÏSÏ	Auditori ligjor në raportin përfundimtar të auditimit “Pasqyrat Financiare vjetore dhe Raporti i auditorit të pavarur 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023” në faqen numër 3, baza për Opinion të kualifikuar, pika “-“ 1, “për shpenzimet e qirasë në vlerën 14,820 euro, nuk ka ndal tatimin në burim në qira, sipas kërkesave ligjore që burojnë nga Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin e mbajtur në Burim”.
2	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	Auditori ligjor në raportin përfundimtar të auditimit “Pasqyrat Financiare vjetore dhe Raporti i auditorit të pavarur 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023” në faqen numër 3, baza për opinion të kualifikuar, pika “-“ 2, “tatimi mbajtur në burim për qira është nënvlerësuar dhe nuk janë deklaruar ne përputhje me kërkesat e Ligjit 06/L-105”.
3	JEDINTSVENA GORANSKA PARTIJA	Auditori ligjor në raportin përfundimtar të auditimit “Pasqyrat Financiare vjetore dhe Raporti i auditorit të pavarur 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023” në faqen numër 3, baza për Opinion të kualifikuar: a) pika “-“ 1, subjekti politik ka deklaruar shpenzimet e pagave bruto në vlerën e përgjithshme prej 4,810 euro, prej të cilës vlerë, për pagën e një të punësuarit në vlerën prej 1,800 euro nuk ka deklaruar dhe paguar kontribute dhe tatim në pagë; b) pika “-“ 2, subjekti politik ka mbivlerësuar shpenzimet e qerasë për vlerën prej 810 euro, për vitin e përfunduar me 31.12.2023, duke i deklaruar në vlerën totale prej 5,970 euro dhe njëkohësisht nuk ka ndalur dhe paguar obligimin për tatimin në qira, ashtu siç kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.
4	SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA	Auditori ligjor në raportin përfundimtar të auditimit “Pasqyrat Financiare vjetore dhe Raporti i auditorit të pavarur 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023” në faqen numër 3, Theksimi i çështjes, pika “-“ 2, obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, janë prezantuar në vlerën prej 1,791 euro. Sipas gjendjes tatimore të muajit janar 2024, obligimet tatimore janë në vlerë prej 2,044.70 euro. Subjekti politik ka deklaruar, por nuk ka përmbushur obligimet tatimore me kohë.

5	YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ	Auditori ligjor në raportin përfundimtar të auditimit “Pasqyrat Financiare vjetore dhe Raporti i auditorit të pavarur 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023” në faqen numër 3, baza për mohim të opinionit, pika “-“ 3, “Subjekti politik për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2023 nuk ka deklaruar dhe paguar obligimet për Tatimin e Mbajtur në Burim në Qira”.
---	--------------------------------	--

7.2. Zyra e Prokurorit të Shtetit

Sipas paragrafit 17 të nenit 19 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, Raportet përfundimtare të auditimit për tri (3) subjekte politike, me datën 18.07.2024, janë dërguar në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, përmes shkresës përcjellëse, me qëllim të vlerësimit se të gjeturat nga raportet mund të përmbajnë elemente të veprës penale, siç përcaktohet në Kodin Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

1. PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM: për shkak të mos bashkëpunimit dhe mos ofrimit të qasjes në dokumente që kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet e subjektit politik.
2. SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA: për shkak të shpenzimit në kundërshtim me qëllim të përdorimit të mjeteve financiare që ndahet nga Buxheti i Kosovës, përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike.
3. SRPSKA LISTA: aktivitetet e realizuara rreth hulumtimit të opinionit publik nga organizatat jo qeveritare të kontraktuara nga subjekti politik, në vlerën 100,000 euro, nuk paraqesin dëshmi bindëse për auditorin, se aktivitetet janë realizuar.

8. Aktivitetet e Zyrës në mbikëqyrjen financiare përgjatë vitit 2024

8.1. Pas pranimit të raporteve vjetore financiare vjetore të vitit 2023, Zyra ka analizuar informatat që lidhen me donacionet që subjektet politike kanë pranuar përgjatë vitit kalendarik 2023. Nga analizimi i informatave, rezultoi se, pesë (5) subjekte politike të regjistruara kanë pranuar donacione në kundërshtim me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

- Subjekti politik LËVIZJA PËR BASHKIM në vitin 2023, ka pranuar donacion nga një person fizik, në shumën 2,400 euro, duke tejkuluar vlerën siç përcaktohet me nën paragrafin 1, paragrafin 1, i nenit 5 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Në lidhje me këtë, Zyra me datën 29.02.2024, përmes shkresës së dërguar, ka kërkuar nga personat e autorizuar të subjektit politik për marrjen e veprimeve që shumën e tejkuluar në vlerën 400 euro, përmes transaksionit bankar, ta kthej tek burimi i pranimit. Subjekti politik ka vepruar sipas kërkesës së Zyrës, brenda afatit të përcaktuar.
- Subjekti politik YENËLIKÇI TÛRK HAREKET PARTISI në vitin 2023, ka pranuar donacione në të holla nga gjashtë (6) persona fizik përmes arkës (para të gatshme) në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Në lidhje me këtë, Zyra me datën 04.03.2024, përmes shkresës së dërguar, ka kërkuar nga personat e autorizuar të subjektit politik për marrjen e veprimeve që shumën e pranuar përmes formës në para të gatshme, t'i kthej tek burimi i pranimit. Subjekti politik ka vepruar sipas kërkesës së Zyrës, brenda afatit të përcaktuar.
- Subjekti politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS në vitin 2023, ka pranuar donacione përmes arkës (para të gatshme) në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Në lidhje me këtë, Zyra me datën 26.03.2024, përmes shkresës së dërguar, ka kërkuar nga personat e autorizuar të subjektit politik për marrjen e veprimeve që shumën e pranuar përmes formës në para të gatshme, t'i kthej tek burimi i pranimit. Subjekti politik nuk ka vepruar sipas kërkesës së Zyrës, brenda afatit të përcaktuar dhe pas konstatimit të auditorit ligjor, Zyra i ka shqiptuar gjobën.
- Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS në vitin 2023, ka pranuar donacione përmes arkës (para të gatshme) në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Në lidhje me këtë, Zyra me datën 01.04.2024, përmes shkresës së dërguar, ka kërkuar nga personat e autorizuar të subjektit politik për marrjen e veprimeve që shumën e pranuar përmes formës në para të gatshme, t'i kthej tek burimi i pranimit. Subjekti politik nuk ka vepruar sipas kërkesës së Zyrës, brenda afatit të përcaktuar dhe pas konstatimit të auditorit ligjor, Zyra i ka shqiptuar gjobën.
- Subjekti politik ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT në vitin 2023, ka pranuar donacione përmes arkës (para të gatshme) në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Në lidhje me këtë, Zyra me datën 12.03.2024, përmes shkresës së dërguar, ka kërkuar nga personat e autorizuar të subjektit politik për marrjen e

veprimeve që shumtë e pranuar përmes formës në para të gatshme, t'i kthej tek burimi i pranimit. Subjekti politik nuk ka vepruar sipas kërkesës së Zyrës, brenda afatit të përcaktuar dhe pas konstatimit të auditorit ligjor, Zyra i ka shqiptuar gjobën.

8.2. Sipas paragrafit 3 të nenit 10 të Rregullores Zgjedhore Nr. 01/ 2024 Regjistrimi dhe Funksionimi i Partive Politike, Zyra përmes shkresës së dërguar me datën 11.07.2024, përmes Sekretariatit të KQZ, nga Zyrtarët Ekzekutiv të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, ka kërkuar informatat për subjektet politike që lidhen me zyrat që shfrytëzohen si seli qendrore nga subjektet politike të regjistruara, duke përfshirë edhe zyrat (degët) që shfrytëzohen nëpër komunat e Republikës së Kosovës.

- Të dhënat e pranuar, do t'i nënshtrohen auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2024, të cilat do të auditohen në vitin 2025.
- Pas pranimit dhe përpunimit të informatave, Zyra planifikon takime me personat e autorizuar të subjekteve politike, për t'i informuar me gjetjet, që do të kenë për qëllim marrjen e veprimeve nga subjektet politike, me qëllim të evidentimit në raportet vjetore financiare për vitin 2024.

8.3. Zyra përgjatë vitit 2023, ka shfletuar ueb faqet e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, me qëllim që të sigurohet se subjektet politike përmbushin nenin 19/A të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, ku obligohen që raportet vjetore financiare të vitit paraprak t'i publikojnë në ueb faqet zyrtare funksionale, që përfshinë edhe raportet për shpenzimet tre mujore dhe përditësimin e listës së donacioneve për çdo tre muaj.

8.4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 21.06.2024, ka miratuar Rregulloren Nr. 06/ 2024 Menaxhimi dhe Mbikëqyrja Financiare e Subjekteve Politike. Në po të njëjtën datë, Zyra përmes komunikimit elektronik e ka dërguar rregulloren tek përfaqësuesit financiar të subjekteve politike, e cila e ka përmbajtur edhe dokumentin njoftues me pika shpjeguese që ndërlidhen me obligimet që kanë subjektet politike të regjistruara, si:

- hapja e llogarive bankare për ato subjekte që nuk kanë llogari bankare;
- detyrimi që subjektet politike duhet ta kenë vetëm një llogari bankare në njërin nga bankat komerciale;
- informatat në lidhje me periudhën kohore të dorëzimit të raporteve vjetore financiare;
- informatat për vlerën e donacioneve që subjektet politike mund të pranojnë përgjatë një viti kalendarik;
- informatat për ndalimin e ndihmave financiare, që përfshinë informatat se në cilat raste subjektet politike nuk mund të pranojnë ndihma financiare;
- informatat dhe pasojat e mos bashkëpunimit me auditorët përgjatë periudhës së auditimit;
- informatat në lidhje me mandatin e Zyrës, për mbikëqyrjen e financave të subjekteve politike dhe shqiptimin e gjobave, etj.

9. Rekomandimet

- 9.1. Përveç gjobave të përcaktuara në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, ky ligj duhet të plotësohet/ ndryshohet, me qëllim të përfshirjes së dispozitave që kanë të bëjnë me pezullimin dhe çregjistrimin e subjekteve politike, në rastet kur nuk përmbushin detyrimet në lidhje raportimin financiar dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me financimin e subjekteve politike.
- 9.2. Marrja e informatave për llogaritë bankare të subjekteve politike të regjistruara, ka paraqitur vështirësi për Zyrën për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra).

REKOMANDIMI: Të specifikohet me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, që bankat komerciale të regjistruara në Kosovë, të obligohen që për çdo vit, t'ia paraqesin Zyrës të dhënat për llogaritë bankare të subjekteve politike të regjistruara, ose të specifikohet si obligim i ndonjë institucioni tjetër i Republikës së Kosovës, që të dhënat bankare të marra nga bankat komerciale, t'i ndajnë me Zyrën, për qëllime të auditimit.

- 9.3. Sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Ligjit për Financimin e Subjekteve, të gjitha subjektet politike duhet të kenë një llogari të vetme në njërën nga bankat komerciale të regjistruara në Republikën e Kosovës.

REKOMANDIMI: Të ndryshohet/ plotësohet paragrafi 3, i neni 4 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, ku subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të ju lejohej t'i kenë dy llogari bankare. Një llogari bankare, e cila i pranon mjetet financiare të ndara nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike dhe një llogari bankare që shërben vetëm për pranim të mjeteve financiare/ kontributet për subjektet politike. Posedimi i llogarisë bankare vetëm për mjetet financiare nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike, mundëson përshtetshmëri të saktë të shpenzimeve të mjeteve nga fondi.

- 9.4. Sipas paragrafit 2 të nenit 19 të Ligjit për Financimin e Subjekteve, Zyra përzgjedh me konkurs të hapur publik auditorët e licencuar, qoftë si person fizik apo person juridik, të cilët do të auditojnë raportet vjetore financiar si dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve.

REKOMANDIMI: Përzgjedhja e auditorëve duhet të kufizohet vetëm në persona juridik dhe procedura e përzgjedhjes duhet t'i nënshtrohet procedurave të prokurimit publik, sepse procedura e përzgjedhjes përmes konkursit të hapur publik komplikohet në rast të paraqitjes së ankesave, ku përmes kësaj procedure, nuk ekziston një autoritet që shqyrton ankesat, sikurse në rastin e procedurës së përzgjedhjes përmes prokurimit publik, ku autoriteti shqyrtues, është Organi Shqyrtues i Prokurimit.

- 9.5. Sipas nenit 8 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, është përcaktuar se për çfarë qëllimesh mund të përdoret Fondi për mbështetjen e Subjekteve Politike.

REKOMANDIMI: Ushtrimi i kontrollit të brendshëm financiar, transparenca dhe ngritja e kapaciteteve brenda subjekteve politike në menaxhimin dhe raportimin e saktë financiar, e bënë të domosdoshme që në kuadër të fondit për mbështetjen e subjekteve politike, të përfshihet mundësia e shfrytëzimit të mjeteve financiare nga Fondi, për qëllime të trajnimeve specifike në kontabilitet.

- 9.6. Sipas nenit 19/A të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, subjektet politike obligohen që t'i publikojnë në ueb faqet zyrtare funksionale, raportin vjetor financiar të vitit paraprak, raportet tre (3) mujore të shpenzimeve dhe ta përditësojnë për çdo tre muaj listën e kontribuuesve. Disa subjekte politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, nuk e kanë përmbushur obligimin e përcaktuar, ose publikimin e raporteve e kanë bërë me vonesë, vetëm pas reagimit të Zyrës.

REKOMANDIMI: Subjektet politike duhet t'i përmbahen obligimit ligjor dhe t'i publikojnë me kohë informatat, siç përcaktohet me nenin 19/A të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.